

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Gjykata Supreme e Kosovës
Ap.-Kz. Nr. 153/2008
Prishtinë

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës ka mbajtur seancën e kolegjit në përputhje me nenin 26, paragrafin (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), dhe nenin 15.4 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (LmK), më datën 12 janar 2010 në ndërtesën e Gjykatës Supreme të Kosovës në kolegjin e përbërë nga gjyqtari ndërkombëtar Gerrit-Marc Sprenger si Kryetar i kolegjit, gjyqtarët ndërkombëtarë Maria Giuliana dhe Emilio Gatti dhe gjyqtarët kosovarë Fejzullah Hasani dhe Tahir Rreci

Dhe me Valentina Gashin si procesmbajtëse,

Në praninë e

Prokurorit publik ndërkombëtar Theo Jacobs nga Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPSHK),

Avokatit mbrojtës E. A. N. për të pandehurin B. K.

Në lëndën penale nr. Ap-Kz 153/2008 kundër të pandehurit:

B. K., i lindur më [redacted], mashkull, shtetas i Kosovës, i kombësisë Shqiptare, vendbanimi i njohur i fundit në Kosovë në Fshatin [redacted] (Komuna e [redacted]), emri i të atit N., mbiemri i vajzërisë i së ëmës H. B., i arratisur nga Burgu i Dubravës (Istog) më 30 nëntor 2008 dhe që prej asaj kohe në arrati.

Në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Pejës (Kp Nr. 412/06), i pandehuri shpallet fajtor për këto vepra penale:

[i] Për kryerjen e veprës penale të Vrasjes së Policëve të Kosovës S. T. dhe H., në kundërshtim të nenit 30, paragrafëve 2 dhe 3 të Kodit Penal të Krahinës

Socialiste Autonome të Kosovës (KP KSAK), e dënueshme edhe sipas neneve 147 dhe 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK);

[ii] Për kryerjen e veprës penale të **Vrasjes në tentativë** të Policit të Kosovës H. L. në kundërshtim të nenit 30, paragrafit 2 të KP të KSAK, lidhur me nenin 19 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ), e dënueshme edhe sipas neneve 147, 20 dhe 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK);

[iii] Për kryerjen e veprës penale **Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm**, në kundërshtim të nenit 157, paragrafi 1 të KP të RSFJ-së, e dënueshme edhe sipas neneve 291 dhe 23 të KPK-së;

[iv] Për kryerjen e veprës penale **Përdorim të paautorizuar të armëve**, në kundërshtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/7, e dënueshme edhe sipas neneve 328, paragrafi 1 dhe 23 të KPK-së;

[v] Për kryerjen e veprës penale **Mbajtje në pronësi të paligjshme të armëve**, në kundërshtim të Rregullosës së UNMIK-ut 2001/7, e dënueshme edhe sipas neneve 328, paragrafi 1 dhe 23 të KPK-së.

Dhe është dënuar:

Me dënim afatgjatë prej **27 (njëzet e shtatë) vjet burgim** për veprën e lartpërmendur penale të Vrasjes, sipas nenit 147, par. 11 të KPK-së.

Avokati mbrojtës i të akuzuarit me kohë ka paraqitur ankesë, më 8 shkurt 2008, e cila është regjistruar në Shkrimoren e Gjykatës së Qarkut të Pejës më 26 mars 2008.

Kështu, Aktgjykimi i shkallës së parë kundërshtohet për 4 (katër) veprat e para penale, për të cilat është dënuar i akuzuari:

- Shkelje të dispozitave esenciale të procedurës penale
- Vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike
- Shkelje të ligjit penal
- Vendim të dënimit

Në ankesën e tij, Avokati mbrojtës propozon ose ndryshimin e aktgjykimit të ankimuar me lirimin e të pandehurit Bedri Krasniqi nga 4 (katër) pikat e para të aktakuzës ose anulimin e Aktgjykimit të shkallës së parë, në veçanti 4 (katër) pikat e para të tij dhe kthimin e lëndës për rigjykim në shkallën e parë.

ZPShK-ja, përmes Prokurores publike ndërkombëtare Deborah Wilkinson, ka paraqitur mendimin dhe propozimin e saj mbi ankesën, të datës 2 dhjetor 2008 dhe ka propozuar refuzimin e ankesës si jomeritore dhe të pabazë, në përputhje me nenin 423 të KPPK-së.

Duke u bazuar në Aktgjykimin me shkrim në lëndën Ap.-Kz. Nr. 153/2008 të Gjykatës së Qarkut të Pejës, Gjykata Supreme e Kosovës, pas këshillimit të mbajtur më 12 janar 2010, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

Sipas nenit 25, par. 1, nenit 26, par. 1, nenit 385, nenit 391, nenit 420, par. 1, nën-par. 2, nenit 423 të KPPK-së ankesa e paraqitur në emër të të akuzuarit **B K** refuzohet.

B K, i lindur më [redacted], mashkull, shtetas i Kosovës, i kombësisë Shqiptare, vendbanimi i njohur i fundit në Kosovë në Fshatin [redacted] (Komuna e [redacted]), emri i të atit **N**, mbiemri i vajzërisë i së ëmës **H B** i arratisur nga Burgu i Dubravës (Istog) më 30 nëntor 2008 dhe që prej asaj kohe në arrati, për veprat penale të vrasjes, vrasjes në tentativë, shkaktim të rrezikut të përgjithshëm, përdorim të paautorizuar të armëve dhe mbajtje në pronësi të paligjshme të armëve, shpallet:

FAJTOR

[i] Për kryerjen e veprës penale të **Vrasjes së Policëve të Kosovës S T** dhe **I H** në kundërshtim të nenit 30, paragrafëve 2 dhe 3 të Kodit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (KP KSAK), e dënueshme edhe sipas neneve 147 dhe 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK);

[ii] Për kryerjen e veprës penale të **Vrasjes në tentativë** të Policit të Kosovës **H L** në kundërshtim të nenit 30, paragrafit 2 të KP të KSAK, lidhur me nenin 19 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ), e dënueshme edhe sipas neneve 147, 20 dhe 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK);

[iii] Për kryerjen e veprës penale **Mbajtje të paautorizuar të armëve**, në kundërshtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/7, e dënueshme edhe sipas neneve 328, paragrafi 1 dhe 23 të KPK-së;

[iv] Për kryerjen e veprës penale **Mbajtje të paautorizuar të armëve**, në kundërshtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/7, e dënueshme edhe sipas nenit 328, paragrafi 2 i KPK-së;

Rrjedhimisht, Gjykata Supreme e Kosovës lëshon këtë:

DËNIM

Vendimi i Shkallës së Parë i Gjykatës së Qarkut në Pejë (Kp Nr. 412/06) i datës 19 shtator 2007 vërtetohet pjesërisht.

Pika e akuzës Përdorim i paautorizuar i armëve ndryshohet në Mbajtje në pronësi të paligjshme të armëve, e dënueshme edhe sipas nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së.

Gjykata vërteton se Pika [iii] e Aktgjykimit të Shkallës së Parë përkatësisht Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm konsumohet nga Pika [i].

I akuzuari B. K. dënohet me burgim afatgjatë prej 27 (njëzet e shtatë) vjetësh për veprën e lartpërmendur penale të Vrasjes, sipas nenit 147, paragrafit 11 të KPK-së.

Sipas nenit 391, par. 5 të KPPK-së, dënimi përfshin edhe kohën që i akuzuari tanimë ka kaluar në paraburgim prej datës 24 mars 2006 deri në arratisjen e tij nga Qendra e paraburgimit në Dubravë më 30 nëntor 2008.

Shpenzimet e procedurës do t'i ngarkohen ankuesit sipas nenit 121, paragrafit 2 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet bazohet në nenin 391, paragrafin 1, pikat (6); nenet 99; 100, paragrafin 2; 102 të KPPK-së.

ARSYETIMI

Historia e procedurës

1. Më 24 nëntor 2003, pas kohë paa ose pas orës 08.00 paradite, Policët e Kosovës S. T. I. H. dhe H. L. ishin duke udhëtuar përgjatë rrugës Deçan-Pejë kur u qëlluan nga një apo më shumë individë të cilët ishin duke vozitur pranë tyre e pastaj ikën me shpejtësi. Si pasojë e të shtënave Policët e Kosovës S. T. dhe I. H. vdiqën nga plagët me armë zjarri. Kurse Polici i Kosovës H. L. pësoi lëndime të rënda, por i mbijetoi sulmit.

2. Prokurori publik në Pejë lëshoi një Aktvendim mbi Fillimin e Hetimeve (ROI) të datës 6 prill 2004, kundër B. K., A. S. dhe M. B. për krimet e përmendura. Hetimet nuk ishin vazhduar e as pezulluar. Më 8 tetor 2004, gjyqtari i procedurës paraprake në Gjykatën e Qarkut në Pejë duke vepruar sipas kërkesë së Prokurorit ndërkombëtar lëshoi një urdhër për arrest dhe një Letërreshtim ndërkombëtar kundër të dyshuarit B. K. I dyshuari është gjetur në Prishtinë më 24 mars 2006 në pronësi të një pistolete Bereta të kalibrit 9mm pa Kartelë Autorizimi për Armëmbajtje. Më 27 mars 2006, gjyqtari i procedurës paraprake shqiptoi paraburgimin kundër të dyshuarit që vazhdohej periodikisht, siç është përshkruar, në përputhje me ligjin.

3. Më 15 shtator 2006, Prokurori ndërkombëtar ka lëshuar aktakuzën kundër të pandehurit B. K. (PP Nr. 185/2004) e cila është paraqitur dhe regjistruar në Gjykatën e Qarkut në Pejë më 21 shtator 2006 prandaj i pandehuri është akuzuar për veprat penale të: **Vrasjes** (në kundërshtim të nenit 30, par. 2 dhe 3 të Kodit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (KP KSAK-së) të kryer në bashkëkryerje); **Vrasjes në tentativë** (në kundërshtim të nenit 30, par. 2 të KP KSAK-së lidhur me nenin 19 të KP RSFJ-së, të kryer në bashkëpunim); **Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm** (në kundërshtim të nenit 157, par. 1 të KP RSFJ-së, të kryer në bashkëpunim); **Përdorim të Paautorizuar të armëve** (në kundërshtim të Rregullores së UNMIK-ut 2001/7, të kryer në bashkëpunim); dhe, **Mbajtje në Pronësi të paautorizuar të armëve** (në kundërshtim të Rregullores së UNMIK-ut 2001/7).

4. Aktakuza është konfirmuar më 15 dhjetor 2006 nga ana e Gjyqtarit ndërkombëtar për konfirmim i Gjykatës së Qarkut në Pejë.

Në të njëjtën ditë, Gjyqtari ndërkombëtar për konfirmim lëshoi një aktvendim të veçantë mbi papranueshmërinë e dëshmitave që vjen nga veprimet hetimore të kryera në vitin 2006, shumë kohë pas datës së skadimit gjashtë (6) muajor 6 tetor 2004, dhe dokumentet e mbledhura nga kjo. Përkatësisht, marrja në pyetje të të pandehurit, B. K., kërkesa e prokurorit dhe lëshimi i urdhrin për masa mbrojtëse lidhur me dy dëshmitarët anonimë, kërkesa e prokurorit për analizën e ADN-së, kërkesa e prokurorit nën nenin 238 të KPPPK-së, për identifikimin e të dyshuarit përmes mundësisë së jashtëzakonshme hetimore, mundësia e jashtëzakonshme hetimore më 20 korrik 2006 para gjyqtarit të procedurës paraprake dhe dëshmia e Dëshmitarit #2 pas rreshtimit të gjashtë njerëzve gjatë shqyrtimit të përmendur.

Më 15 shkurt 2007, Gjykata Supreme e Kosovës hodhi poshtë ankesën e Prokurorit publik ndërkombëtar në fund të procesit ankimor duke vërtetuar vendimin e Gjyqtarit për Konfirmim.

5. Shqyrtimi gjyqësor filloi më 15 maj 2007 dhe vazhdoi përfshirë gjithsej 10 (dhjetë) seanca deri më 19 shtator 2007.

Pas dëgjimit të shumë dëshmitarëve gjatë seancave të mëparshme, më 3 korrik 2007 është propozuar pranimi i deklaratës së dëshmitarit "A" të dhënë në polici nga përfaqësuesi i palës së dëmtuar pasi që dëshmitari nuk është paraqitur në gjykatë edhe pas ftesave detyruese, dhe së fundi nuk është gjetur. I pandehuri dhe avokati mbrojtës në mënyrë specifike i kanë thënë gjykatës se atyre nuk ju nevojitet mundësia e paraparë me nenin 156, paragrafin 2 të KPPPK-së për ta marrë në pyetje dëshmitarin. Ata janë pajtuar që të lexohet deklarata e tij në procesverbal. Gjykata ka gjetur se kjo ka qenë rrethanë e veçantë e arsyeshme, brenda dispozitave të nenit 154, paragrafit 2 të KPPK-së dhe nuk ka mundur të është parashihet nga Gjyqtari për konfirmim. Prokurori është pajtuar që dëshmitë të pranohet dhe me aktvendimin e 3 korrikut 2007, kolegji ka urdhëruar që deklarata e dëshmitarit "A" do të jetë pjesë e shkresave të lëndës.

6. Me aktvendimin e njëjtë të gjykatës të datës 3 korrik 2007, për pranimin e dëshmimeve, gjykata gjithashtu ka bërë konstatimet në vijim: i) Sipas nenit 368, paragrafit 1, nënparagrafit 3 të KPPPK-së, pas marrëveshjes mes palëve dhe avokatit mbrojtës, intervista e dëshmitarit "B", deklaratat e dëshmitarëve A. H., S. F., V. H., N. L., I. B. dhe A. K. dhe transkriptimi i audio intervistës i dëshmitarit të mbrojtur "B" të muajit prill 2006 do të përfshihet në procesverbal dhe që kjo do të jetë pjesë shkresave të lëndës, dhe ii) Pas kërkesës së Prokurorit publik ndërkombëtar, për analiza të ADN-së sipas dispozitave të nenit 192 lidhur me nenin 195 të KPPPK-së, analiza e ADN-së nuk mund të bëhet pa urdhër të gjykatës, mund të mos ketë kufizime për periudhën brenda cilës mund të bëhet kërkesa për një urdhër të tillë në mungesë të një kufizimi të tillë, gjykata në secilën fazë të procedurës ka kompetenca sipas statutit dhe të qenësishme për të lëshuar urdhër lidhur me masat mbrojtëse për analiza të ADN-së. Përfundimisht, gjykata ka gjetur se rezultati i urdhrin për analizë të ADN-së mund të jetë i pranueshëm në cilëndo fazë të procedurës.

7. I pandehuri B. K. është dënuar me 27 (njëzeteshtatë) vjet burgim më 19 shtator 2007 me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë (P. Nr. 412/06), për veprat penale:

- Vrasjen e Policëve të Kosovës S. T. dhe I. H. në kundërshtim të nenit 30, paragrafëve 2 dhe 3 të KP KSAK-së, të dënueshme edhe sipas neneve 147 dhe 23 të KPK-së;
- Vrasjen në tentativë të Policit të Kosovës H. L. në kundërshtim të nenit 30, paragrafit 2 të KP KSAK-së lidhur me nenin 19 të KP RSFJ-së, të dënueshme edhe sipas nenit 147, 20 dhe 23 të KPK-së;
- Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm, në kundërshtim të nenit 157, paragrafit 1 të KP KSAK-së, të dënueshëm edhe sipas neneve 291 dhe 23 të KPK-së;
- Shfrytëzim dhe posedim i paligjshëm i armëve, në kundërshtim të Rregullores së UNMIK-ut 2001/7, të dënueshme edhe sipas neneve 328, paragrafit 1 dhe 23 të KPK-së,

8. I pandehuri në të vërtetë ka pranuar fajësinë vetëm për akuzën në pikën e 5-të. Gjatë arrestimit të tij më 24 mars 2006, B. K. kishte në posedim dhe personalisht ka sjellë jashtë shtëpisë së tij një pistoletë Beretta kalibri 9mm, pa ndonjë leje për armëmbajtje. Në deklaratën e të pandehurit të datës 25 mars 2006 dhe dëshmisë së tij para Gjyqtarit të procedurës paraprake më 27 mars 2006, K. në mënyrë të sinqertë ka pranuar posedimin e pistoletës në fjalë.

9. Brenda të njëjtit aktgjykim i cili dënoi të pandehurin B. K. për krimet e lartpërmendura, Gjykata e Qarkut në Pejë, sipas nenit 393, paragrafit 5 të KPK-së, me një aktvendim të veçantë të lëshuar më 19 shtator 2007 ka vazhduar paraburgimin e B. K. derisa aktgjykim i bëhet i formës së prerë. Aktgjykim i është komunikuar të pandehurit, prokurorit, qendrës së paraburgimit dhe Gjykatës së Qarkut në Pejë në versionet në gjuhët angleze dhe shqipe më 5 shkurt 2008, dhe avokatit mbrojtës të të pandehurit më 8 shkurt 2008.

10. Në ndërkohë, B. K. është arratisur nga Burgu i Dubravës më 30 nëntor 2008. Më 1 dhjetor 2008, Drejtori i Burgut të Dubravës ka lëshuar një Letërreshtim sipas nenit 544, paragrafëve 3 dhe 4 të KPPK-së lidhur me arratisjen.

11. Ankesa e avokatit mbrojtës e datës dhe e paraqitur më 18 shkurt 2008 është paraqitur me kohë pranë Gjykatës së Qarkut në Pejë në pajtim me nenin 398, paragrafin 1 dhe nenin 399, paragrafin 1 të KPPK-së.

Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës ka paraqitur mendimin dhe propozimin e tyre të datës 2 dhjetor 2008 pranë kësaj gjykate në të njëjtën ditë.

GJETJET E GJYKATËS

12. Gjykata Supreme nuk ka gjetur ndonjë bazë për kundërshtimin e aktgjykimit të shkallës së parë e as shkelje të ligjit nën nenin 415 të KPPK-së (neni 423 i KPK-së).

A. Shkelje substanciale e dispozitave të Procedurës Penale

I. PRANUESHMËRIA E DEKLARATAVE TË DËSHMITARËVE TË KONSIDERUARA SI DËSHMI NGA GJYKATA E SHKALLËS SË PARË

1.) Mbi pranueshmërinë e deklaratave të dëshmitarëve:

13. Avokati mbrojtës në ankesën e tij ka theksuar se Aktgjykimi i shkallës së parë është bazuar në dëshmi të papranueshme dhe prandaj ka të bëjë me nenin 403, paragrafin 1, nënparagrafët 8 dhe 12 dhe nënparagrafi 2, pikat 1-2 të KPPK-së. Gjykata kishte shkelur nenin 156, paragrafin 2 të KPPK-së sepse dëshmitë nuk ishin mbledhur sipas ligjit. Gjykata posaçërisht ka marrë parasysh deklaratat e dëshmitarit "A" dhe dëshmitarit të mbrojtur "B" të dhëna në Polici si dhe dëshmitë e dhëna nga dëshmitarët A. H., S. F., V. H., N. L., I. B. dhe A. K.. Deklaratat e tyre janë përfshirë në procesverbal edhe pse mbrojtja nuk ishte pajtuar për këtë. Mbrojtja ishte pajtuar vetëm për "leximin e tyre gjatës procedurës gjyqësore". Pasi që nuk kishte ndodhur kështu, mbrojtja nuk ka pasur mundësi që ti kundërshtonte dëshmitë. Kjo së pari do t'i referohet dëshmisë së dëshmitarit "A" i cili nuk është paraqitur në gjykatë fare.

14. Pas kontrollimit të procesverbaleve të shqyrtimeve përkatëse, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se nuk ka papranueshmëri të deklaratave të dëshmitarëve siç pohohet nga Avokati mbrojtës.

15. Ndërsa dëshmitari i mbrojtur "B" në kundërshtim me pohimet e ankesës kishte deklaruar personalisht para gjykatës së shkallës së parë më 27 qershor 2007, dhe prandaj mbrojtja ka pasur mundësi që ta marrë në pyetje dëshmitarin dhe të kundërshtojë deklaratën e tij, dispozita përkatëse mbi pranueshmërinë e deklaratave të dëshmitarëve në përgjithësi është neni 156, paragrafi 2 i KPPK-së i cili përcakton si në vijim:

(2) Deklarimi i dëshmitarit i dhënë në polici ose para prokurorit publik mund të jetë provë e pranueshme në gjykatë vetëm kur të pandehurit ose mbrojtësit i është dhënë mundësia ta kundërshtojë atë nëpërmjet marrjes në pyetje të dëshmitarit gjatë ndonjë fazë të procedurës penale.

16. Në seancën e mbajtur më 3 korrik 2007, avokati mbrojtës në mes tjerash ka propozuar që në procesverbal të përfshihen deklaratat e pesëmbëdhjetë dëshmitarëve të dhëna në Polici, të cilët nuk janë deklaruar asnjëherë para gjykatës, të përfshihen në procesverbal. Sipas procesverbalit të seancës së gjykatës të datës 3 korrik 2007 (f. 4), ai në këtë kontekst qartazi i referohet dëshmitarëve në vijim:

Policë:

- R. Z.
- G. K.
- S. F.
- M. B.
- B. A.
- R. S.

Civil:

- A. H.
- V. H.
- V. H.
- S. Z.
- B. F.
- N. L.
- V. B.
- I. B.
- A. K. alias G.

17. Me kërkesë të Kryetarit të kolegjit, mbrojtja ka theksuar që të merren parasysh pesë nga këta dëshmitarë, përkatësisht G. K., S. F., A. H., V. H. dhe N. L. si *esencial*, edhe pse atij nuk i dukej vendimtare që të dëgjohen ndonjëri nga ata para gjykatës (f. 5 e procesverbalit të datës 3 korrik 2007).

Me kërkesë të mbrojtjes, gjykata e shkallës më 3 korrik 2007 së parë ka vendosur që ti pranoj dëshmitë e dhëna në polici të dëshmitarëve S [redacted], F [redacted], A [redacted] H [redacted], V [redacted] H [redacted], N [redacted] I [redacted], I [redacted] B [redacted] dhe A [redacted] K [redacted] dhe t'i përfshij ato në procesverbal në mënyrë që të jenë pjesë e shkresave të lëndës (Aktvendimi i datës 3 korrik 2007 (KP. Nr. 412/06), f.2). Deklaratat në fjalë të dëshmitarëve në polici të gjitha ishin marrë menjëherë pas krimit në dhjetor 2003 dhe prandaj nuk duhet të konsiderohen jashtë periudhës hetimore e cila ka përfunduar më 6 tetor 2004.

18. Nënkuptohej se përmes propozimit të tij avokati mbrojtës ka hequr dorë nga e drejta e tij për marrjen në pyetje dhe konfrontimin me dëshmitarin në fjalë sipas nenit 156, paragrafit 2 të KPPK-së. Sipas nenit 368, paragrafit 1, nënparagrafit 3 të KPPK-së...*dëshmitë e dëshmitarëve...mund të lexohen sipas vendimit të trupit gjykues...nëse palët pajtohen për marrjen e drejtpërdrejtë në pyetje të dëshmitarit... i cil ka dështuar që të paraqitet,..., të zëvendësohet me leximin e procesverbalit të mbi ekzaminimit e tij apo saj të mëparshëm.*

Kuptimi i vetëm i mundshëm i propozimit të avokatit mbrojtës për leximin e deklaratave pa i dëgjuar vetë dëshmitarët para gjykatës është se avokati mbrojtës duke e përfaqësuar të pandehurin është pajtuar që të merren parasysh këto deklarata pa i marrë në pyetje dëshmitarët përsëri në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Për ta thënë me fjalët e Prokurorit publik në mendimin mbi ankesën, duket e pavlerë që tani mbrojtja pretendon në papranueshmërinë e dëshmitëve; ai vetë ka propozuar më parë që të konsiderohet nga gjykata e shkallës së parë. Me kërkesë të Prokurorit publik, i cili e bëri këtë kusht për pajtimin e tij, avokati mbrojtës kishte konfirmuar në mënyrë të qartë në gjykatë se heq dorë nga ankesa mbi këtë çështje, duke thënë në këtë mënyrë: “nëse pajtohem që të përfshihen ato (dëshmitë e dëshmitarëve) në procesverbal, pse do të bëja ankesë?” (Procesverbali i gjykatës i datës 3 korrik 2007, f.7).

19. Gjithashtu **deklaratat e dëshmitarit të mbrojtur “A”** janë përfshirë në procesverbalin e seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 3 korrik 2007. Përderisa kjo është bërë, në propozimin e palëve të dëmtuara, gjithashtu lexohet qartë nga procesverbali i seancës (f. 8-9) që i pandehuri është pajtuar që të vazhdohet në mënyrën e cekur. Për këtë arsye i pandehuri dhe avokati i tij mbrojtës gjithashtu kanë heq dorë nga e drejta për të marrë në pyetje në mënyrë të drejtpërdrejtë dëshmitarin para gjykatës.

2.) Mbi kushtet e nenit 368, paragrafit 1 të KPPK-së:

20. Nga sqarimet verbale të avokatit mbrojtës gjatë seancës së 12 janarit 2010, Gjykata Supreme kupton se mbrojtja është e brengosur lidhur me faktin se më 3 korrik 2009 deklaratat e lartpërmendura të dëshmitarëve janë marrë parasysh si pjesë e procesverbalit, mirëpo pa i përfshirë ato fizikisht dhe kjo mund të konsiderohet si shkelje e nenit 368, paragrafit 1 të KPPK-së.

21. Gjykata Supreme gjen se nuk ka shkelje të nenit 368, paragrafit 1 të KPPK-së, e cila mund të shpie në prishjen e aktgjykimit të shkallës së parë. Dispozita përcakton si në vijim:

(1) Përveç rasteve të parapara me këtë Kod, procesverbalet mbi deklaratimet e dëshmitarëve, të bashkakuarve ose pjesëmarrësve të dënuar për vepër penale, si dhe procesverbalet dhe shkresat tjera mbi konstatimin dhe mendimin e ekspertit, sipas vendimit të trupit gjykues mund të lexohen vetëm në këto raste:

- 1) Kur personat e marrur në pyetje kanë vdekur, kanë çrregullime ose paaftësi mendore, nuk mund të gjenden ose ardhja e tyre në gjykatë është e pamundur apo dukshëm e vështirësuar për shkak të pleqërisë, sëmundjes ose shkaqeve të tjera të rëndësishme;*
- 2) Kur dëshmitarët ose ekspertët, pa arsye ligjore, nuk dëshirojnë të dëshmojnë në shqyrtim gjyqësor ose*
- 3) Kur palët pajtohen që, në vend të marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje të dëshmitarit apo ekspertit i cili nuk është i pranishëm, pavarësisht se ka qenë i thirrur, të lexohet procesverbali mbi dëshminë e tij të mëparshme.*

Edhe pse formulimi i dispozitës përkatëse si dhe konteksti sistematik nën Kapitulli XXXIV, neni 7 (paraqitja e dëshmimeve) të KPPK-së, dhe posaçërisht neni 364 i ligjit tregon në mënyrë të qartë se së pari kërkohet leximi fizik i dëshmisë së diskutueshme nga kryetari i kolegjit, Gjykata Supreme konsideron se kjo nuk ka qenë e nevojshme në këtë lëndë dhe fakti që kjo nuk është bërë nuk e shkel ligjin në atë mënyrë që aktgjykimi duhet patjetër të prishet. Qëllimi i nenit 368, paragrafit 1 të KPPK-së është që të sigurojë se të gjitha palët në gjykim janë në dijeni të përbërjes dhe rëndësisë specifike të deklaratës së dëshmitarit, në këtë mënyrë duke u ballafaquar me propozimin për ta marrë parasysh deklaratën si pjesë të procesverbalit.

22. Në këtë lëndë, mund të lexohet qartë në procesverbalin e datës 3 korrik 2007 se vetë avokati mbrojtës kishte propozuar që deklaratat në polici të dëshmitarëve G. K., S. F., A. H. V. dhe N. L. të përfshihen në procesverbal dhe se në atë kohë ai tanimë kishte njehuri për ato dhe ishte i gatshëm që ai vetë ti lexonte ato me zë (procesverbali i gjykatës i datës 3 korrik 2007, f.3). Nga i njëjti dokument (f.4) mësohet se ai gjithashtu kishte njohuri lidhur me përmbajtjen e video-intervistës së dëshmitarit të mbrojtur "B". Avokati mbrojtës në këtë kontekst ka theksuar qartë se nuk kishte nevojë për të që të lexohen këto dokumente me zë në gjykatë, por të "përfshihen në procesverbal" vetëm (f. 4 dhe 5). Gjithashtu bëhet e qartë nga procesverbali se pas propozimit të Përfaqësuesit të palëve të dëmtuara pyetja është diskutuar, se a do të pajtohet apo jo avokati mbrojtës që deklaratat në polici të dëshmitarëve të mbrojtur "A" të përfshihen në procesverbal dhe se avokati mbrojtës si dhe i pandehuri në atë kohë kanë pasur njohuri për përmbajtjen e kësaj dëshmie të diskutueshme (f.5) dhe konsiderimi i saj asnjëherë nuk është kundërshtuar nga Përfaqësuesi i palëve të dëmtuara, mund të

kuptohet se të gjitha palët e shqyrtimit gjyqësor kanë ditur për dëshminë në fjalë dhe rëndësinë e saj për lëndën. Prandaj, mënyra se si është marrë parasysh kjo dëshmi nga gjykata e shkallës së parë mbulohet me nenin 368, paragrafi 1 i KPPK-së.

II. PAPANUESHMËRIA E DËSHMIVE TJERA TË KONSIDERUARA NGA GJYKATA PËR SHKAK SE ATO JANË MBLEDHUR PAS NDËRPRERJES SË HETIMEVE

23. Përfundimisht, sipas ankesës, shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale do të ndodhë lidhur me faktin se aktgjykimi i shkallës së parë është bazuar në dëshmitë të cilat janë mbledhur në shkelje të neneve 220 dhe 225 të KPPK-së, që do të thotë se edhe pse procedura paraprake nuk është vazhduar dhe në këtë mënyrë është ndërprerë. Prandaj, të drejtat e avokatit mbrojtës, të mbrojtura me nenin 403, paragrafin 1, nënparagrafin 2, pikat 1 dhe 2 të KPPK-së, janë shkelur.

24. Gjykata Supreme e Kosovës në rend të parë gjen se pretendimet përkatëse të ankesës nuk janë fare të bazuara. Prandaj, nuk është as e mundshme e as e nevojshme që kolegji për ankesa në këtë kontekst të shkoj në detaje.

25. Pavarësisht nga ky fakt, bëhet e qartë nga Aktvendimet e Gjyqtarit për Konfirmim se pranueshmëria e secilës dëshmi është kontrolluar me kujdes një nga një. Kjo tanimë mund të lexohet në Aktvendimin për konfirmim të datës 15 dhjetor 2006 (KP 412/06). Posaçërisht ky i fundit vendos qartë se periudha e hulumtimit formal ka skaduar më 6 tetor 2005 dhe se të gjitha dëshmitë e mbledhura nga Prokurori publik pas asaj date konsiderohen si të papranueshme për shkak të faktit së periudha e hetimeve nuk është vazhduar. Në pajtim me këtë, asnjëra nga këto dëshmi nuk është pranuar në gjykim.

26. Prapëseprapë, duket e nevojshme që të përqendrohemi mbi hollësitë e mendimit të ekspertit përkitazi me analizën e ADN-së, e cila është kërkuar dhe është dorëzuar pas përfundimit të periudhës së hetimeve por është konsideruar të jetë e pranueshme nga ana e kolegjit të shqyrtimit gjyqësor. Nga ana tjetër, më 15 dhjetor 2006, gjyqtari për konfirmimin e aktakuzës në Gjykatën e Qarkut të Pejës nuk ka pranuar kërkesën e Prokurorit për analizën e ekspertit të ADN-së për shkak të faktit se e njëjta është dorëzuar pas skadimit të periudhës së hetimeve më 6 tetor 2004, edhe pse kolegji i shqyrtimit gjyqësor kishte mendim tjetër. Me Aktvendimin e datës 3 korrik 2007, Kryetari i kolegjit të gjykatës së shkallës së parë ka vendosur që kërkesa për analizë të ADN-së do të ishte dëshmi e pranueshme, pasi që nuk kishte kufizim të periudhës brenda së cilës mund të kërkohet urdhri i gjykatës për analizë të ADN-së, në përputhje me nenin 192, lidhur me nenin 195 të KPPK-së (Aktvendimi i gjykatës i datës 3 korrik 2007, faqe 4).

27. Gjykata Supreme e Kosovës, pas kontrollimit të pjesëve përkatëse të shkresave të lëndës konstaton se kërkesa e Prokurorit të Gjykatës së Qarkut të Pejës për lëshimin e

një urdhri mbi analizën e ADN-së mban datën 1 shtator 2006, përderisa Urdhri mbi analizën e ADN-së i Gjyqtarit të procedurës paraprake në Gjykatën e Qarkut të Pejës mban datën 7 shtator 2006 ndërsa Raporti i ekzaminimit të ADN-së (me numër të lëndës 511-01-41-III/01-9402 në Qendrën e mjekësisë ligjore “Ivan Vucetic” në kuadër të Ministrisë së punëve të brendshme të Republikës së Kroacisë, është lëshuar më 6 dhjetor 2006 dhe pas kësaj i është dorëzuar Gjykatës.

Në përgjithësi, është e rëndësishme të thuhet se vërtet ligji nuk parasheh asnjë vendim të qartë nëse kërkesa për analiza të ADN-së është e pranueshme apo jo dhe nëse urdhri i gjykatës lidhet me skadimin e periudhës hetimore, siç është diskutuar në mes të Gjyqtarit për konfirmim dhe Kryetarit të shqyrtimit gjyqësor në këtë lëndë. Duhet të përmendet se periudha hetimore e cila fillon me Aktvendimin mbi fillimin e hetimeve, të lëshuar nga prokurori publik, posa të konstatohet se ka dyshim të arsyeshëm për kryerjen e veprës penale, është e kufizuar në 6 (gjashtë) muaj – dhe në rast të vazhdimit deri në maksimum 18 (tetëmbëdhjetë) muaj (Nenet 220 dhe 225 të KPPK-së). Nga ana tjetër, sipas Nenit 192, lidhur me nenin 195 të KPPK-së, asnjë analizë e ADN-së nuk guxon të bëhet pa urdhër të gjyqtarit.

Përgjigja mund të gjendet në Nenin 220, par. 3 të KPPK-së, që përcakton qëllimin e hetimit si më poshtë:

(3) Qëllimi i hetimit është mbledhja e dëshmive dhe e të dhënave të nevojshme për të vendosur mbi ngritjen e aktakuzës apo ndërprerjen e procedurës dhe mbledhjen e dëshmive, të cilat nuk mund të prezantohen gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Mbi këtë bazë mund të kuptohet se kufizimi kohor i periudhës hetimore nuk përjashton në tërësi mbledhjen e dëshmive të reja pas skadimit të saj. Kjo është edhe më e rëndësishme pas ngritjes me kohë të aktakuzës, prandaj qëllimi i periudhës së hetimeve është përmbushur. Në veçanti, në rast të analizës së ADN-së lehtë mund të imagjinohet që një mostër që pretendohet të jetë e rëndësishme është marrë gjatë procedurës, por një kohë të gjatë pas mbylljes së hetimeve. Nëse në këto raste skadimi i periudhës së hetimeve do të përjashtonte mundësinë e marrjes parasysh të këtyre dëshmive të reja dhe ndoshta vendimtare, kjo gjë do të shpinte thjesht në eliminimin e pjesëve të rëndësishme të dëshmive që nuk do të ishte në interesin e ligjvënësit.

28. Në këtë lëndë, aktakuza është ngritur më 15 shtator 2006, d.m.th. pas dorëzimit të kërkesës për ADN në gjykatë dhe pas lëshimit të urdhrit të gjykatës për analizën e ADN-së, por shumë kohë para përgatitjes dhe dërgimit të Raportit të ekzaminimit të ADN-së. Megjithatë, pasi që nuk kishte rezultat pozitiv të analizës së ADN-së për shkak të faktit se nuk ishte gjetur sasi e mjaftueshme e materialit të ADN-së, çështja ka natyrë të pastër akademike dhe pa asnjë ndikim në rastin në fjalë. Për këtë arsye, nuk ka nevojë që të vendoset mbi çështjen e përmendur. Mund të konsiderohet se dëshmitë e parëndësishme nuk ndikojnë fare në aktgjykim, siç është thënë qartë edhe në ligjin e vjetër (neni 364, par. 1, pika 8 e Ligjit jugosllav mbi Procedurën Penale (LPP).

I. PAQARTËSIA E DISPOZITIVIT PËR SHKAK TË CITIMIT TË GABUAR TË NENEVE PËRKATËSE TË KPK-së MBI VEPRËN PENALE

29. Ankesa po ashtu pretendon se dispozitivi nuk mund të kuptohet, ngase citimet e veprave penale dhe cilësimi i tyre juridik do të ishte i paqartë. Dispozitivi po ashtu do t'iu referohej edhe dispozitave përkatëse të KP të KSAK-së si dhe atyre të KPK-së, edhe pse do të ishte e pamundur të zbatoheshin të dy ligjet në të njëjtën kohë.

30. Rishikimi i Aktgjykimit të shkallës së parë tregon qartë se nuk ka mospërputhje ose moskuptim të dispozitivit, duke cituar në të njëjtën kohë dhe duke i përzier edhe dispozitat nga KPK-ja edhe nga KP i KSAK-së. Gjykata në Aktgjykimin e saj ka përmendur me saktësi *emërtimin juridik të veprës dhe dispozitat e ligjit penal të zbatuar*, ashtu siç kërkohet me dispozitën përkatëse të nenit 391, par. 1, nënpar. 2 të KPPK-së.

Pasi që veprat penale në fjalë janë kryer më 24 nëntor 2003, kjo do të thotë se të njëjtat janë kryer para hyrjes në fuqi të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), tash KPK, i cili ka hyrë në fuqi më 6 prill 2004. Për këtë arsye, ligj i zbatueshëm penal është KP i KSAK-së, i cili pa asnjë përjashtim është zbatuar dhe cituar nga gjykata e shkallës së parë, gjë e cila po ashtu mund të lexohet qartë edhe në dispozitivin e Aktgjykimit të kundërshtuar. Në këtë kuptim, mund të theksohet se dispozitivi po ashtu u referohet edhe dispozitave përkatëse të KPK-së, të cilat janë aktualisht të zbatueshme duke vënë kështu veprat penale nën dënimin pas datës 6 prill 2004. Megjithatë, është qartë e kuptueshme që gjykata e shkallës së parë nuk ngatërron dispozitat e kodeve penale të periudhave të ndryshme kohore, por është vetëm e interesuar që shkurtimisht ta theksojë se këto vepra penale janë të dënueshme edhe me ligjin e tanishëm në fuqi.

B. Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike

I. GABIMI I GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË PËR GJETJET E VETA FAKTIKE

31. Fokusi kryesor i ankesës shtrihet në miratimin e fakteve siç bëhet nga gjykata e shkallës së parë. Avokati mbrojtës në ankesën e vet, diskuton gjerësisht mendimet dhe interpretimet e veta lidhur me dëshmitë e ndryshme në një mënyrë e cila ndryshon nga mënyra e gjykatës së shkallës së parë. Sipas avokatit mbrojtës, gjykata nuk kishte vërejtur shumë mospërputhje brenda për brenda një numri të madh të deklaratave të dëshmitarëve, siç bie fjala në veçanti:

1. përfshirja e një veture Audi në këtë krim, pasi që sipas shumë deklaratave të dëshmitarëve marka e kësaj veture ndryshon herë në Audi herë në Mercedes;
2. edhe nëse vetura tashmë është përcaktuar qartë si një Audi, nuk do të mund të thuhet nëse kjo veturë Audi e cila ka shkuar në drejtim të fshatit Raushiq po vinte nga rruga kryesore në mes të Pejës dhe Deçanit, ku ndodhi krimi;
3. jo të gjitha gëzhojat e gjetura në Audi (por vetëm disa prej tyre) kishin qenë identike me ato të gjetura në vendin e krimit, përderisa disa të tjera nuk ishin shkrepur nga automatiku AK-47 dhe disa mund të kenë qenë më të vjetra
4. i pandehuri B. K. nuk kishte qenë brenda në Audi, pasi kishte ndodhur krimi; kjo do të shfaqej edhe në deklaratën e policit S. Z., i cili do ta kishte njohur të pandehurin shumë mirë por nuk e kishte njohur atë edhe pse u përball me veturën Audi menjëherë pas krimit; sa u përket dëshmitarëve të tjerë (dëshmitarëve të mbrojtur "B" dhe "A" siç është konfirmuar edhe nga polici G. K.) ata e kishin identifikuar të pandehurin në një foto të albumit të policisë dhe e kishin cilësuar atë si shoferin ose kishin deklaruar se atë e kishin identifikuar dëshmitarë të tjerë, ose këto identifikime nuk ishin të besueshme ose vetë këta dëshmitarë nuk ishin të besueshëm;
5. i pandehuri kurrë, madje as ditën e krimit as ndonjëherë tjetër, nuk ka vozitur veturë Audi të bardhë, por të kaltër të mbyllur; edhe pse dëshmitarët kishin deklaruar të kundërtën (polici R. B.), ata nuk do të ishin të besueshëm;
6. nuk është dëshmuar pozitivisht se i pandehuri B. K. ndonjëherë të ketë qenë brenda veturës Audi; nuk është sjellë rezultati pozitiv i mostrës së ADN-së si "dëshmi e shekullit"; vetëm një nga tri gjurmët e gishtërinjve të gjetura në hapësinë e gepekut të veturës Audi është përcaktuar qartë si gishti i majtë i mesëm i të pandehurit, përderisa të tjerët madje as nuk dihet nëse janë të tij; kjo do të ishte edhe më vendimtare sikur vendi i krimit dhe objekti i kompanisë MOLIKA si dhe vendi ku ishte gjetur vetura Audi në fshatin Rosuje të mos kishin qenë nën kontrollin e plotë të policisë por të kontaminuar më 24 dhe 25 nëntor 2003.

E vetmja pasojë e mundshme për gjykatën që të vendosë lidhur me rastin, sipas mbrojtjes, kishte qenë vendimi *in dubio pro reo* siç përcaktohet me nenin 3, paragrafin 2 të KPK-së.

32. Pas rishikimit të procesverbalit të të gjitha 10 (dhjetë) seancave të shqyrtimit gjyqësor si dhe arsytimit të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Supreme konstaton se asnjë nga argumentet e Avokatit mbrojtës lidhur me çështjen nuk është bindës. Gjetjet faktike të gjykatës së shkallës së parë si dhe

vlerësimet e saj mbi dëshmitë mbështeten nga logjika dhe arsyetimi i kuptueshëm dhe i shëndoshë.

1.) Gjykata e shkallës së parë ka marrë një spektër të plotë dhe të shëndoshë të dëshmimeve, si më poshtë:

33. **Dëshmitë e marra:** Pasi më 15 maj 2007, i pandehuri është deklaruar “i pafajshëm” për të gjitha akuzat e sjella kundër tij përveç njëres e cila ka të bëjë me Mbajtje e paligjshme e armëve, është dëgjuar dëshmitari I. B. Dëshmitarët N. L., R. B., J. F. dhe F. Z. janë marrë në pyetje para gjykatës më datën 22 maj 2007, përderisa më 23 maj 2007 dëshmitari R. B. ka dhënë dëshminë e tij. Më 29 maj 2007 dëshmitarët V. A., B. P., H. A., I. J. dhe Sh. Z. kanë dëshmuar para kolegjit të shqyrtimit gjyqësor, ndërsa më 26 qershor 2007 deklaratat e tyre i kanë dhënë edhe dëshmitarët I. K., I. G. dhe M. B. Më 27 qershor 2007, është dëgjuar dëshmitari i mbrojtur “B”, përderisa dëshmitari i mbrojtur “A”, edhe pse i ftuar me kohë, nuk është paraqitur fare. Përkundër kësaj, deklarata e tij e dhënë para policisë është futur në procesverbalin e datës 3 korrik 2007, me propozimin e Përfaqësuesit të palëve të dëmtuara, me të cilin janë pajtuar të gjitha palët, siç është shtjelluar edhe më herët (pika A.I. e këtij arsyetimi, faqe 9, pika 19 dhe faqe 10, pika 22). Përfundimisht, më 2 korrik 2007 janë marrë në pyetje edhe dëshmitarët G. K., O. S. dhe H. B.

Më 3 korrik 2007, dosja e mjekësisë ligjore Nr. 03-369 (2003-DA-3581), e cila veç ishte pjesë e procesverbalit, është dorëzuar si dëshmi pa vonesë, para të gjitha palëve. Po ashtu, ka dëshmuar edhe i pandehuri. Për më tepër, përveç leximit të deklaratës së dëshmitarit të mbrojtur “A” të dhënë në polici, të gjitha palët janë pajtuar edhe me intervistën e regjistruar me video të dëshmitarit të mbrojtur “B” si dhe me deklaratat në polici të dhëna nga dëshmitarët A. H., S. F., V. H., N. L., I. B. dhe A. K., që të gjitha këto të futen në procesverbal, gjë e cila është bërë, siç është theksuar edhe më herët (pika A.I. e këtij arsyetimi). Edhe pse Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar si të papranueshme kërkesën për ADN dhe për ekspertizë, është konsideruar se nuk ka pasur rezultat pozitiv sa i përket ADN-së, për shkak të mungesës së materialit të mjaftueshëm të ADN-së.

2.) Gjykata e shkallës së parë ka shtjelluar dhe ka vlerësuar dëshmitë dhe ka mbështetur mendimin e saj si në vijim:

34. **Llojin dhe formën e veturës:** Dëshmitarët I. B., F. Z., R. B., S. Z. si dhe dëshmitari i mbrojtur “B” dhe dëshmitarët N. L., I. B. dhe A. K. kanë deklaruar se menjëherë pas të shtënave, ata kanë parë një Audi me ngjyrë të çelur, e cila

është përshkruar në të shumtën e rasteve si e bardhë, përderisa dëshmitari A K [redacted] e ka identifikuar si e hirtë e çelur, ndërsa dëshmitari F [redacted] Z [redacted] e ka përcaktuar ngjyrën si të verdhë. Dëshmitari i mbrojtur A në disa raste gjatë javës e ka përshkruar veturën si Audi të bardhë me tre persona brenda, me viktimën e ndjerë S [redacted] T [redacted], para se të kryheshin këto krime. Vetëm dëshmitari V [redacted] H [redacted], dëshmia e të cilit është konstatuar të mos jetë në përputhje me gjetjet e mjekësisë ligjore në vendin e krimit, kishte deklaruar se vetura nga e cila ishte shtirë ishte një Mercedes i bardhë/i hirtë metalik. Në fillim këtë ide e kishte edhe dëshmitari A K [redacted], i cili më vonë e kishte përmirësuar veten duke thënë se kjo veturë ka mundur të jetë edhe Audi. Sipas dëshmitarëve B [redacted] P [redacted] dhe J [redacted], ata kishin takuar një vajzë të re, derisa po kërkonin veturën e kryerësve në rrugën për [redacted]. Edhe ajo gjithashtu kishte vërejtur një Audi të bardhë me një gomë të shfryrë, duke shkuar rrugës [redacted] me një shpejtësi të madhe. Goma e shfryrë po ashtu ishte konfirmuar edhe nga dëshmitarët S [redacted] Z [redacted] dhe R [redacted] B [redacted].

35. **Gjetja e veturës:** Dëshmitari R [redacted] B [redacted] më në fund ka gjetur një Audi 80 të bardhë, pas njoftimit se patrulla e policisë po kërkonte veturën e kryerësve. Vetura Audi ishte nja 5 deri në 6 kilometra nga fshati Turjakë dhe ishte e siguruar me shiritin e policisë. Dëshmitari J [redacted] F [redacted] në këtë kuptim ka konfirmuar se nga një largësi prej rreth 30 metrash ai pa Audinë e bardhë dhe vërejt dy persona të armatosur, të cilët kishin dalë nga vetura dhe po mundoheshin ta shtynin atë, pasi vetura kishte ngecur në baltë. Duke pasur parasysh se vetura nuk mund të shtyhet me sukses pa pasur edhe shoferin brenda saj, ai supozoi se ishte edhe personi i tretë ulur brenda në veturë para timonit. Ky dëshmitar ia doli që me sukses ta përshkruante në më shumë hollësi së paku njërin prej personave jashtë veturës. Në këtë kuptim, gjithashtu edhe dëshmitari N [redacted] A [redacted], i cili konfirmoi 80% të deklaratës së tij të dhënë në polici por nuk tha se cili 20 përqindësh ishte gabim, theksoi se policia kishte gjetur gjurmë këmbësh rreth veturës në baltë dhe se ishte një gëzhjojë në pjesën e ulëseve të para të veturës. Dëshmitari i mbrojtur "B" më në fund identifikoi veturën e bardhë Audi nga një foto, të cilën ia tregoi policia, të cilën e kishte parë duke u larguar nga vendi i krimit.

36. **Numri dhe përshkrimi i personave brenda veturës:** Dëshmitarët I [redacted] B [redacted], R [redacted] B [redacted], dëshmitari i mbrojtur "B", N [redacted] I [redacted] dhe A K [redacted] kanë deklaruar se kishte më shumë sesa një (1) person brenda veturës prej të cilës u shtie dhe ata pjesërisht kanë bërë përshkrimin e këtyre personave brenda veturës. Përderisa I [redacted] B [redacted] ishte i mendimit se ishin gjithsej 4 (katër) persona së bashku në veturë dhe sipas observimit të tij, shoferi ishte një biond i madh me flokë të shkurtër pothuaj me kokë të rruar, Ramadan Buqolli kishte parë 3 (tre) persona brenda veturës, ndërsa dëshmitari i mbrojtur B kishte identifikuar 2 (dy) persona ulur në pjesën e përparme të veturës dhe kishte pohuar se edhe në person tjetër ka mundur të jetë prapa në veturë. Megjithatë, pasi dëshmitari i mbrojtur B dhe të tjerët njohën shoferin si burrë me kokë të rruar që duket si biond i ri i moshës 23 deri në 25 vjet dhe

me sy të kaltër. N. L. përshkroi biondin e ri me kokë të rruar ulur prapa në veturë, ndërsa A. K. pa dy persona përpara dhe një prapa, të gjithë të një gjatësie rreth 170 – 180 cm dhe në mes moshës 20 dhe 30 vjeç, me flokë të shkurtër. Edhe pse dëshmitari në fillim fliste për flokë me ngjyrë kafe apo të zeza të personave brenda, ai më vonë kishte theksuar se nuk ishte aspak i sigurt për ngjyrën e flokëve.

37. Identifikimi i vozitësit: Së fundi dëshmitari i mbrojtur “B” identifikoi vozitësin e veturës në albumin e fotografive në Polici siç paraqitet në fotografinë nr. 7, e cila është fotografia e të pandehurit B. K. Në deklaratën e tij në Polici edhe dëshmitari i mbrojtur “A” identifikoi personin në fotografinë 7. në të njëjtin foto album të policisë, prandaj i pandehuri B. K., si vozitësi i veturës Audi të bardhë, që kishte brenda tre persona të identifikuar mirë dhe të cilët dëshmitari i kishte parë disa herë gjatë javës, para se të ndodhnin vrasjet. Vetëm dëshmitari S. Z., i cili i kishte njohur dy personat që ishin të ulur në ulëset e përparme të Audi-së, nuk identifikoi B. K. si vozitës, duke deklaruar se ai njëjti të pandehurin dhe do ta ishte identifikuar. Megjithatë, dëshmitari e bëri të qartë se identifikimi nuk ishte i mundur për të, pasi që nuk kishte rastin ti shihte fytyrat. Në fund, dëshmitari R. B. deklaroi se disa muaj përpara vrasjeve gjatë një ndaljeje për kontrollim në trafik ai kishte ndaluar të pandehurin gjersa ishte duke vozitur veturën Audi të bardhë- apo ngjyrë banane.

38. Besueshmëria e dëshmitarëve: Gjykata e shkallës së parë në këtë kontekst morri parasysh faktin se disa dëshmitarë më nuk mbanin mend të gjitha detajet e deklaratave të mëparshme në polici, kur deklaroheshin para Gjykatës. Megjithatë, dëshmitari I. B. potencoi se ai kishte deklaruar të vërtetën para policisë dhe qëndroi prapa deklaratës së tij. Po ashtu edhe R. B. konfirmoi përmbajtjen e dëshmiave të dhëna në polici më 10 janar 2004 dhe nënshkrimi i poshtëshënuar ishte i tij. Në të njëjtën mënyrë, dëshmitari B. P. konfirmoi përmbajtjen e deklaratës së tij të dhënë në polici më 23 dhjetor 2003 dhe më 10 shkurt 2004 siç kishte bërë edhe dëshmitari I. J. në lidhje me deklaratën e tij në polici të datës 26 nëntor 2003. Dëshmitari N. A. theksoi se vetëm 80 % e deklaratave të tij në polici do të ishin të sakta por ai refuzoi të provojë, se cili 20 % nuk do të përputhej me vështrimet e tij. Prandaj, kolegji morri parasysh vetëm tërësinë e kësaj dëshmie. Së fundi, dëshmitari i mbrojtur “B” – pasi konfirmoi së pari se kishte deklaruar të vërtetën para policisë – më vonë plotësisht mohoi përmbajtjen e deklaratës së tij të dhënë në polici më 04 dhjetor 2003 dhe më 14 janar 2004. Ai tha se kishte qenë i keqtrajtuar nga policia; duke shkuar në shtëpinë e tij pa paralajmëruar dhe sepse fëmijët e tij ishin frikësuar. Gjykata morri në pyetje Policin e Kosovës G. K. mbi këtë pohim, i cili e kishte intervistuar dëshmitarin e mbrojtur “B”. Dëshmitari Kelmendi theksoi, në mes tjerash, se pas marrjes së dëshmisë ai së pari ia kishte lexuar

deklaratën dëshmitarit të mbrojtur "B" pikë më pikë dhe pastaj kishte kërkuar nga ai të nënshkruajë pas secilës përgjigje që kishte dhënë.

39. Ekspertiza e gjurmëve të gishtërinjve: Eksperti i UNMIK-ut për gjurmë të gishtërinjve Nasko Lalev deklaroi para Gjykatës dhe u bazua në ekspertizën e tij me shkrim. Ai theksoi se duke u bazuar në gjetjet e gjurmëve të gishtërinjve në gepekun e Audi 80 4 (katër) fotografi gjurmësh të gishtërinjve ju ishin dërguar atij përmes Policisë hetues dhe se njëra prej tyre, gjurma e gishtërinjve A-2, ishte krahasuar me bazën e të dhënave AFIS me dhjetë gjurmë të UNMIK-ut. Me atë rast, gishti i djathtë i mesëm i kandidatit APIS#KS008469 u konstatua të jetë identik me gjurmën e paqartë të gishtërinjve, i cili ishte krahasuar me të dhënat e gjithsej 50 kandidatëve. Në këtë mënyrë u konstatua se gjurma e gishtit i takonte të pandehurit, B [REDAKTUAR]
K [REDAKTUAR]

40. Alibia e të pandehurit: Gjykata e shkallës së parë po ashtu ka marrë parasysh deklaratat e të pandehurit si dhe të dëshmitarëve të Mbrojtjes I [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR], M [REDAKTUAR] B [REDAKTUAR] dhe Z [REDAKTUAR] e G [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR], të cilët kanë nënvizuar se çdo përfshirje e të pandehurit në këto vrasje është e vështirë të besohet për shkak se ai ka alibi. Kurse i pandehuri ka deklaruar se më 24 nëntor 2003, në mëngjesin e kryerjes së krimeve, ai ishte zgjuar në mes orës 07:00 dhe 07:30 dhe pastaj kishte shkuar për të prerë ca dru, më parë ai kishte ndihmuar kushërinjtë e tij në ndërtimin e një ahuri lopësh, dëshmitari I [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR] vërtetoi se në ditën e diskutueshme i pandehuri ishte në shtëpinë e tij para orës 07:00 në mëngjes, por se ai e kishte parë të pandehurin rreth orës 07:00 duke qëndruar në ballkonin e tij duke fërkuar sytë. Më vonë ai kishte qenë me të mes orës 07:30 dhe 09:00. Dëshmitari I [REDAKTUAR] G [REDAKTUAR] të cilit i kujtohet saktësisht 24 nëntori 2003, pasi që ishte nata e Bajramit, por që nuk i kujtohet asgjë në natën e Bajramit të vitit 2005, deklaroi se kishte shkuar në shtëpinë e të pandehurit mes orës 06:30 dhe 07:00 dhe se ky i fundit i kishte thënë se babai i tij kishte shkuar në Pejë dhe dëshmitari M [REDAKTUAR] B [REDAKTUAR] tha se ai kishte parë të pandehurin përpara shtëpisë së tij mes orës 07:00 dhe 07:10. Kurse dëshmitarët I [REDAKTUAR] G [REDAKTUAR] dhe M [REDAKTUAR] B [REDAKTUAR] nuk mbanin mend fare se i pandehuri kishte vozitur ndonjëherë Audi të bardhë, dëshmitarët Z [REDAKTUAR] dhe G [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] deklaruan pozitivisht se B [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR] nganjëherë voziste një Audi 80 me ngjyrë të kaltër të mbyllët. Megjithatë, Gjykata e shkallës së parë e konsideroi deklaratën e I [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR] si të pambështetur sa i përket fakteve materiale dhe atë të I [REDAKTUAR] G [REDAKTUAR] edhe të paqëndrueshme në brendësi. Gjykata po ashtu konstatoi se dëshmia e M [REDAKTUAR] B [REDAKTUAR] kundërshton në një masë atë të I [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR], gjersa deklaratat e Z [REDAKTUAR] dhe G [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] nuk përjashtojnë faktin se i pandehuri ka vozitur Audi të bardhë siç është dëshmuar nga dëshmitarët tjerë.

41. Ekspertiza balistike: Në fund, Gjykata e shkallës së parë konstatoi se sipas Shkresave Mjeko-ligjore të Lëndës Nr. 03-369 (2003-DA-3581) gëzhojat e kalibrit 7.62 mm të gjetura në vendngjarje te vetura Audi e

braktisur ishin të ngjashme me gëzhojat e kalibrit 7.62 mm të gjetura në vendngjarjen e vrasjeve dhe se ishte vërtetuar se viktimat kishin vdekur nga plagët me armë zjarri të shkaktuara nga armët e kalibrit 7.62 x 39 mm.

42. Sidoqoftë, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se nuk është as në kompetencë të kolegjit ankimor e as e mundur të zëvendësohen në fakt gjetjet e Gjykatës së shkallës së parë me gjetje të veta, sidomos jo pa i marrë përsëri të gjitha dëshmitë. Në lëndën *Runjeva, Axhami dhe Dema (Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZ 477/05 datë 25 janar 2008, faqe 20)*, Gjykata Supreme e Kosovës në këtë kontekst ka theksuar se “*procedura ankimore në KPPPK qëndron në parimet se shqyrtimi, vlerësimi dhe peshimi i dëshmive në gjykim varet nga gjykata që është duke gjykuar [...]. Prandaj, gjykata ankimore kërkohet nderojë gjykimin në gjetjet e saj faktike. Ajo nuk duhet ti trazojë gjetjet e gjykatës së gjykimit e ti zëvendësojë me atë të vetat, përveç nëse dëshmitë e mbështetura nga gjykata e gjykimit nuk kanë mundur të pranohen nga asnjë gjykatë e arsyeshme ku vlerësimi i tyre ka qenë tërësisht i gabuar*”. Kjo sentencë është dhënë edhe në lëndën e *Jeton Kiqinës (Gjykata Supreme e Kosovës, Ap.-Kz. Nr. 84/2009 datë 03 dhjetor 2009, p. 19)*. Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës për detajet e dëshmive të marra dhe vlerësimin dëshmive siç është bërë nga Gjykata e shkallës së parë i referohet arsyetimit të Aktgjykimit të shkallës së parë.

II. MOSARRITJA E GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË VËRTETOJË PLOTËSISHT FAKTET DUKE MOS FTUAR DHE MOS MARRË NË PYETJE NJËMBËDHJETË DËSHMITARË TË PROPOZUAR NGA MBROJTJA

43. Avokati mbrojtës thekson po ashtu në ankesë se së paku njëmbëdhjetë dëshmitarë të propozuar nga mbrojtja nuk janë marrë parasysh nga Gjykata e shkallës së parë, por janë refuzuar vetëm njëherë me anë të një memorandumit me shkrim (P. Nr. 171/07, të datës 26 mars 2007). Lista e dëshmitarëve që i referohet mbrojtja është kjo:

1. Ni [redacted] L [redacted], Fshati [redacted], datë: 24/11/2003;
2. S [redacted] Z [redacted], Fshati [redacted], datë: 24/11/2003;
3. B [redacted] F [redacted], Fshati [redacted], datë: 24/11/2003;
4. V [redacted] B [redacted], Fshati [redacted], datë: 24/11/2003;
5. I [redacted] B [redacted], Fshati [redacted], datë: 24/11/2003;
6. B [redacted] B [redacted], Fshati [redacted], datë: 24/11/2003;
7. R [redacted] Z [redacted], Police në ndjekje të personave të dyshimtë më 24/11/2003;
8. F [redacted] H [redacted], infermiere në Fshatin [redacted], Deçan, për veturat që ajo i ka parë në segmentin rrugor Pobërgjë -Carabreg gjatë javës para veprës penale;
9. G [redacted] K [redacted] Polic, për (mos-)intervenimin nga R [redacted] B [redacted], në lidhje me kthimin e dokumenteve të veturës AUDI;

10. B [redacted] A [redacted], Polic, së bashku me

11. M [redacted] B [redacted] Polic në lidhje me ndaljen e veturës AUDI më 18/11/2003

44. Gjykata Supreme ka kontrolluar dokumentet përkatëse të shkresave të lëndës dhe posaçërisht kërkesën për dëshmi të datës 26 mars 2007 (P. nr. 171/07) së cilës i referohet avokati mbrojtës si dhe procesverbalin e seancave të shqyrtimit gjyqësor të Shkallës së parë mbi propozimin e avokatit mbrojtës për të marrë parasysh deklaratat e caktuara të dëshmitarit. Kështu që, u konstatua se jashtë listës, që u prezantua nga ankesa e avokatit mbrojtës, të gjithë dëshmitarët janë marrë parasysh gjatë procedurës së shqyrtimit gjyqësor, përveç dëshmitarëve të propozuar I [redacted], V [redacted] dhe B [redacted] B [redacted]. Dëshmitarët G [redacted] S [redacted] dhe Z [redacted] S [redacted] të cilët nuk janë pjesë e listës së diskutueshme por të kërkesës për dëshmi të datës 26 mars 2007, pra duke qenë të propozuar për historinë e pronësisë së veturës Audi të bardhë, janë shqyrtuar në Gjykatë më 27 qershor 2007. Prej listës, pra Pika II e propozimit të dëshmisë, deklaroi më 22 maj 2007 para Gjykatës dëshmitari R [redacted] B [redacted] dhe dëshmitari J [redacted] F [redacted] u mor në pyetje nga Gjykata gjatë seancës më 23 maj 2007. Marrja në pyetje personalisht e dëshmitarëve të tjerë nga lista apo si alternativë leximi i tyre në procesverbal të deklaratave të tyre në polici u diskutua më 03 korrik 2007, kur avokati mbrojtës kishte kërkuar që deklaratat e 15 dëshmitarëve në polici të lexohen në procesverbal. Deri më tani, është përmendur shtjellimi i bërë nga kolegji nën pikën A. I. (faqe 8-9, pikat 16. dhe 17.) të këtij arsyetimi. Në këtë kontekst tanimë ishte vërtetuar se mbrojtja deklaroi, me kërkesë të Kryetari të kolegjit, se vetëm pesë deklarata të dëshmitarit do të jenë "esenciale", siç u potencua më lart. Këto pesë deklarata të dëshmitarit u lexuan në procesverbal, me çka u pajtuan Prokurori si dhe avokati mbrojtës.

45. Ky i fundit po ashtu ndriçoi faktin se dëshmitarët I [redacted], V [redacted] dhe B [redacted] B [redacted] nuk ishin marrë parasysh nga Gjykata e shkallës së parë. Ata as nuk ishin propozuar nga avokati mbrojtës, kur më 03 korrik 2007 atë e kishin pyetur ti tregojë Gjykatës kush ishin dëshmitarët esenciale të mbrojtjes për tu marrë parasysh nga Gjykata.

46. Përveç kësaj nuk është shumë e qartë se kujt i referohet mbrojtja në këtë kontekst. Edhe pse dy listat e siguruara të dëshmitarëve (ajo për të cilën u diskutua më 03 korrik 2007 dhe ajo që u paraqit në Gjykatë përbrenda kërkesës për dëshmi të datës 26 mars 2007) ndryshojnë prej njëra tjetrës, që të dyja njësoj i referohen tetë dëshmitarëve, pra R [redacted] Z [redacted], G [redacted] K [redacted], M [redacted] B [redacted], B [redacted] A [redacted], S [redacted] Z [redacted], B [redacted] F [redacted], N [redacted] L [redacted] dhe I [redacted] B [redacted], por që mbrojtja më 03 korrik 2007 ka deklaruar se shumica e tyre nuk janë esenciale.

47. Sa i përket listës së dytë të dëshmitarëve, Mbrojtja asnjëherë nuk deri më tani nuk e ka kërkuar gjatë shqyrtimit gjyqësor të shkallës së parë, krahas tre dëshmitarëve të familjes B [redacted] përkatësisht F [redacted] H [redacted]. Gjykata

Supreme kupton se Mbrojtja tani ka për qëllim të prezantojë këta dëshmitarë në procedurë dhe ti marrë në pyetje ose së paku deklaratat e tyre në polici të lexohen në procesverbal nga kolegji ankimor. Megjithatë, pasi që kolegji ankimor nuk merr dëshmi të reja siç u potencia edhe në hapjen e seancës në 12 janar 2010, tani nuk mund të merren parasysh dëshmitarët e propozuar të rinj.

C. Shkelja esenciale e Ligjit Penal

I. MBI KUSHTET LIGJORE TË BASHKËKRYERJES DHE BASHKËPUNIMIT

48. Avokati mbrojtës në ankesën e tij po ashtu ka theksuar se Gjykata e shkallës së parë gabimisht ka cilësuar veprat penale si të kryer në bashkëpunim, edhe pse identiteti i bashkëkryerësit të pretenduar nuk ishte vërtetuar. Sipas nenit 22 dhe 23 të KP KSKA-së, nuk ka as bashkëkryerje e as bashkëpunim me kryerës të panjohur.

49. Mbrojtja nuk citon asnjë autoritet për propozimin e saj se është e domosdoshme të identifikohen bashkëkryerësit për të cilësuar se një vepër është kryer në bashkëpunim nën nenin 22 të.

Neni 22 përkatës i KP RSFJ-së përcakton siç vijon:

Nëse disa njerëz marrin pjesë në një vepër penale apo në ndonjë mënyrë bashkohen në bashkëpunim, secili prej tyre do të dënohen në përputhje me dënimin e përshkruar.

Edhe pse nuk ka tjetër definicion përveç këtij definicioni të varfër ligjor, literatura definon bashkëpunimin me KP të RSFJ-së si “një vepër të vetëdijshme dhe të qëllimtë të shoqërimit me pjesëmarrës tjerë, me qëllim të kryerjes së një veprë bashkërisht” (Ljubisha Lazarevic, Komentimi i Kodit Penal të RFJ-së 1995, botimi i pestë, “Savremena Administracija” Beograd, f. 66, pika (1) mbi nenin 22 RSFJ).

50. Pa diskutim, ky definicion kërkon një grup njerëzish, që bashkëpunojnë me dashje me qëllim të kryerjes së një krimi. Natyrisht, pasi që përgjegjësia penale gjithmonë është domosdoshëm personale, të gjitha teoritë formale-objektive si dhe subjektive mbi bashkëpunimin, që kanë ndikim në cilësinë e pjesëmarrjes në krim si kryerës kryesor apo vetëm si një ndihmës, po ashtu kërkojnë një person të definuar qartë si bashkëpjesëmarrës. Parimi i individualitetit përfshin personin e pjesëmarrjes si dhe të vetë veprës. Çdo kuptim tjetër lehtë mund të çojë deri te një situatë të jo-përgjegjësisë penale.

Megjithatë, edhe duke marrë parasysh komponentin objektiv si dhe subjektiv të bashkëpunimit si vepër, duke u bazuar në dashjen e personit që kryen vepër (që kjo e fundit kërkon një person prapa veprimit), në anën tjetër nuk ka nevojë për organet e hetuesisë apo për gjyqtarin të njohë të gjithë kryerësit a një krimi me të dhëna personale, nëse mund të vërtetohet, në cilën mënyrë është kryer krimi dhe nëse mund të përcaktohet së paku njëri nga grupi i pretenduar i kryerësve përfshirë edhe përfshirjen e tij/saj në krim. Nënkuptohej se mungesa e informatës mbi bashkëkryerësit tjerë nuk mund të rezultojë se një person nën dyshimin arsyeshëm për kryerje të një krimi nuk do të ndiqet penalisht dhe/ose të dënohet në përputhje me ligjin.

51. Në këtë lëndë nuk ka dyshim se krimi është kryer vetëm nga një por së paku nga dy e ndoshta edhe tre autorëve të krimit. Të gjithë dëshmitarët të cilët kanë deklaruar për veturën e autorëve të pretenduar, kanë parë së paku tre persona brenda veturës. Gjithashtu edhe pa kurrfarë dyshimi se medoemos se ka qenë bashkëpunim i afërt dhe ndarje e detyrave në mes të autorëve të ndryshëm të krimit. Gjykata e shkallës së parë sugjeron se – përderisa një prej të burgosurve të veturës ka qenë vozitësi, një apo dy udhëtarët tjerë të veturës duhet të kenë shtënë me armë(t), ndërsa vozitësi duhej të sillte veturën tek caku dhe e bëri largimin e tij (Aktgjykimi i shkallës së parë i datës 19 shtator 2007, f. 38). Bazuar në këto të gjetura faktike, gjykata e shkallës së parë drejtësisht ka vlerësuar se vepra penale është kryer së bashku prej më tepër se një person, por duke përfshirë të pandehurin B. K. Edhe nëse i pandehuri nuk ishte qitësi i vërtetë, pjesëmarrja e tij në veprën e kryerjes – duke e pozicionuar veturën në mënyrë që qitësit të qëllonin dhe pastaj të largohet me shpejtësi-demonstron përgjegjësinë e tij si bashkëfajtor me nenin 22 të KP të RSFJ-së. Nuk ekziston asnjë kërkesë ligjore që identiteti i bashkëfajtorëve të tjerë të vërtetohet me qëllim të gjetjes së të pandehurit të vetëm fajtor për veprën penale siç është bashkëfajësia, me kusht që faktet në shkresa mbështesin gjetjen që vepra penale është kryer së bashku.

52. E njëjta do të aplikohet në veprën penale duke ndihmuar veprën e dikujt tjetër, sipas nenit 24 të KP të KSAK-ut, pasi që ndihma njihet si formë tjetër e mundshme për bashkëfajësi (Ljubisha Lazarevic, Komentet e Kodit Penal të ish RJ-së 1995, botimi i 5-të, “Savremena Administracija” Beograd, f. 76, pika (1) në nenin 24 KP RSFJ-së). Edhe pse pyetja e asistencës gjithashtu është adresuar prej avokatit mbrojtës brenda ankesës, nuk ka nevojë të shkohet më thellë në detaje sepse i pandehuri nuk ishte as i akuzuar as i dënuar për asistencë dhe aktgjykimi i shkallës së parë nuk është kundërshtuar deri më tani.

II. MBI POSEDIMIN E PAAUTORIZUAR DHE/OSE PËRDORIMIT TË ARMËVE

53. Gjykata Supreme gjithashtu kupton se i pandehuri sipas gjetjeve të gjykatës së shkallës së parë nuk ka përdorur asnjë armë kur ai ishte duke i vozitur qëlluesit deri te vetura e viktimave kështu që gabimisht është dënuar sipas nenit 8.3 të Rregullorës së UNMIK-ut nr.2001/7, e cila ende transmetohet si e ndëshkueshme sipas nenit 328, paragrafi 1, 23 i KPK-së. Në lëndën në fjalë mund të lihet e hapur në këtë kontekst, nëse përdorimi i veturës me qëllim që dikush tjetër të vras personin duke shtënë disa shpërthime të municionit jashtë dritares mund të konsiderohet si përdorim i paautorizuar i armëve sipas ligjit për bashkëkryerje.

54. Dosido, duhet të konsiderohet që përdorimi i armës me qëllim të kryerjes së vrasjes duhet të shihet si lëndë e ndërlydhjes ideale në mes të dy veprave përkatëse penale. Tashmë në lëndën e *O. Z. et al., të datës 21 korrik 2009 (Ap-Kz 481/2008)*, Gjykata Supreme ka vendosur se me rastin e veprave tjera penale, që janë kryer si pjesë e vrasjes, siç d.m.th: *përdorimi i pautorizuar i armës për kryerjen e vrasjes, autori i krimit nuk mund të dënohet për krimin e përdorimit të paautorizuar të armës sepse kjo pjesë e vrasjes që i vihet në barrë, këtu duhet të gjej aplikim të veprës penale të posedimit të paautorizuar të armës në pajtim me nenin 328 paragrafi 2 i KPPK-së.*

55. Megjithatë, i pandehuri e ka ditur se së paku një prej pasagjerëve tjerë të veturës Audi, të cilën ai ishte duke e vozitur, ka pasur armë, gjoja se ka pasur me vete mitraloz AK-47 me qëllim të vrasjes tre pjestarët e PK-së deri sa po udhëtonin në veturën e tyre. Për këtë arsye i pandehuri iu afrua duke vozitur veturës së viktimave dhe qëllloi në ta duke vrarë dy prej tyre dhe me mundësi të lëndimeve të të tretit. Prandaj, është e padyshtimtë se ai me dëshirë ka pasur mitralozin (-ët) në sferën e tij të ndikimit, e që ishte vetura Audi dhe në këtë mënyrë ka kryer veprë penale të posedimit të paligjshëm të armëve në bashkëkryerje me qëlluesin, e cila është e nevojshme prej nenit 8.2 të Rregullorës së UNMIK-ut nr.2001/7, ende e ndëshkueshme sipas nenit 328, paragrafi 2 dhe 23 të KPK-së.

III. MBI SHKAKTIMIN E RREZIKUT TË PËRGJITHSHËM

56. Përfundimisth, sa i përket dënimit të të pandehurit për Shkaktim të Rrezikut të Përgjithshëm në kundërshtim me nenin 157, paragrafi 1 i KP të KSAK-ut, tani e ndëshkueshme me nenin 23 dhe 291 të KPK-së, Gjykata Supreme gjen se kjo pjesë e veprës është konsumuar me pikën 1 të aktgjykimit, e cila është vrasje në kundërshtim të nenit 30, paragrafeve 2 dhe 3 të KP të KSAK-ut, tani të ndëshkueshme me nenin 23 dhe 147, paragrafi 11 të KPK-së.

Neni 157, paragrafi 1 të KP të KSAK-ut përcakton siç vijon:

(1) Kushdo që me zjarrvënie, vërshim, shpërthim, helmim apo gaz helmues, jonizim të rrezatimit, fuqi motorike apo elektrike se me çfarëdo vepre tjetër të rrezikshme apo mjeteve të rrezikshme në përgjithësi rrezikon jetën apo trupin njerëzor apo pronën e konsiderueshme, do të ndëshkohet me burgim në kohëzgjatje prej 6 muajsh deri në 5 vite.

57. Nuk mund të ketë asnjë dyshim që kërkesat e dispozitës gjithashtu janë dhënë edhe në kushtet e rrezikut konkret. Mund të lexohet prej dëshmive të dëshmitarëve përkatës që të shtënat kanë ndodhur në rrugën shumë të frekuentuar dhe së paku tre persona ishin duke ecur përgjatë Kompanisë MOLIKA, e që është vendngjarja e krimit, kur të shtënat kanë filluar. Për më tepër, rreziku ishte konkretizuar personalisht tek pjesëtari i PK-së H. L. i cili ka marr plagë të rënda gjatë të shtënave.

58. Megjithatë, mund të lexohet prej komenteve në nenin 187 të KP të RSFJ-së, e cila në kushtet e lëndës në fjalë përcaktoi ngjashëm me nenin 157, paragrafi 1 të KP të KSAK-ut, që *si rregull duhet të konsiderohet bashkëveprimi i veprës penale të shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm me veprën penale të lëndimeve të rënda trupore ... ose të lëndimit të lehtë trupor ...*, por që, nëse vrasja e paramenduar është kryer në mënyrë që autori i krimit me paramendim rrezikon jetën e personit tjetër, atëherë duhet të ekzistoj vetëm rasti i kualifikuar i vrasjes prej nenit 47, paragrafi 2, pika 3. (Srentic Nikola/Ljubisa Lazarevic; Komentet e Kodit Penal të Serbisë viti 1995, Botimi i 5-të, "Srevremena Administracija", Beograd; neni 187 KP i RSFJ-së, paragrafi 34 dhe 35). Prandaj, në lëndën në fjalë është dhënë vendosja e ndërthurjes ideale në mes të veprave penale të Vrasjes në kundërshtim me nenin 30, paragrafi 2 të KP të KSAK-ut dhe Shkaktimi i Rrezikut të Përgjithshëm në kundërshtim me nenin 157, paragrafi 1 të KP të KSAK-ut. Si pasojë – pavarësisht prej pyetjes së fajsisë për të dy veprat, e cila natyrisht që është dhënë – sjellja përkatëse penale është e ndëshkueshme vetëm një herë.

D. Vendimi mbi ndëshkimin

59. Përfundimisht, sipas ankesës, Gjykata e Shkallës së Parë ka gabuar në vendosjen e dënimit për të pandehurin pasi që nuk ka pasur baza ligjore për ta shpallur atë fajtor.

60. Ky pohim i avokatit mbrojtës është asgjë më tepër se tautologji. Asnjë argument mbi bazën ligjore për kundërshtimin e vendimit mbi dënimin nuk janë paraqitur përveç të faktit që sipas këndvështrimit në lëndën dhe mendimit ligjor të marr prej mbrojtjes, vlerësimi i fakteve e gjithashtu edhe aplikimi i dispozitave

përkatëse ligjore do të duhej të shpinte në shfajësimin *in dubio pro reo* për të pandehurin.

61. Për më tepër, dënimi është korrekt dhe i drejtë.

Gjykata e Shkallës së Parë e shpalli të pandehurin fajtor veçmas për të gjitha pikat që ishte i viheshin në barrë, por në mënyrë korrekte vërtetoi dënimin me burgimin afatgjatë vetëm për vrasje, e cila sipas nenit 147, pika 11 e KPK-së në këtë rast është vetëm kualifikim relevant që duhet të konsiderohet. Pamvarësisht, prej faktit se Gjykata e Shkallës së Parë e ka shpallur të pandehurin fajtor veçmas për veprën penale të Shkaktimit të Rrezikut të Përgjithshëm, përderisa kjo pikë tashmë është absorbuar prej pikës së Vrasjes, kjo konsideratë nuk ka kurrfarë ndikimi në saktësinë e dënimin të shpallur. Sepse neni 147, pika 11 e KPK-së, posaçërisht një dënim unik nuk mund të sillen në rastet, kur dikush kryen dy apo më tepër vrasje pasi që krimi më me ndikim të cilin ligji e njeh (e gjithashtu edhe veprat tjera penale, të cilat në kushtet e rëndësisë së tyre penale mund të rreshtohen nën Vrasje). Tashmë në lëndën e *O. Z. et al., të datës 21 korrik 2009 (Ap-Kz 481/2008)*, Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur që në rastin (lëndën) e vrasjes dhe të tentim vrasjes të kryer me qëllim, në të njëjtin kontekst të kohës dhe hapësirës Gjykata duhet të përdor rrethanat rënduese të përcaktuar me nenin 147, pika 11 e KPPK-së dhe të konsideroj të dy faktet si vepër të vetme penale. Kjo rrethanë rënduese gjen aplikim edhe pse vrasja e dytë mbetet tentim sipas dispozitës ligjore të nenit 20 të KPPK-së.

Sa i përket drejtësisë së vendimit të kundërshtuar, Gjykata e Shkallës së Parë në pajtim me komizën e dënimeve të mundshme të dhëna prej ligjeve përkatëse, që i referohet veprave të ndryshme penale të kryera, ka sjell një dënim të vetëm afatgjatë prej 27 (njëzet e shtatë) viteve burgim për Vrasje të dy pjesëtarëve të PK-së (neni 30, paragrafi 2, të KP të KSAK-ut, në lidhje me nenet 22 dhe 24 të KP të RSFJ-së) dhe kështu që në tërësi përputhet me dispozitat e nenit 147, paragrafi 11 të KPK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se Gjykata e Shkallës së Parë në mënyrë korrekte dhe në tërësi ka marr në konsideratë të gjitha rrethanat që ndikojnë në rreptësinë e dënimin dhe i ka vlerësuar drejtësisht këto rrethana. Prandaj, nuk ekziston asnjë arsye që të zbutet dënimi.

Duke marr parasysh nivelin e rrezikut social të kryerjes së veprave penale e gjithashtu edhe nivelin e përgjegjësisë së të akuzuarit, këtij të fundit i është shqiptuar dënimi i merituar unik.

Për shkak të arsyeve paraprirëse Gjykata Supreme ka vendosur si në dispozitiv.

Anëtar i Kolegjit

Maria Giuliana Civinini

Kryetari i Kolegjit

Gerrit-Marc Sprenger

Anëtar i Kolegjit

Emilio Gatti

Anëtar i Kolegjit

Fejzullah Hasani

Anëtar i Kolegjit

Tahir Rreci